


UJËRAT BREGDETARE TË VENDIT TONË



Bregdeti i Shqipërisë përfshin pjesë të Detit Adriatik dhe Detit Jon.


Plazhet kryesore për të cilat është kryer monitorimi për cilësinë e ujërave të tyre, janë plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Tales, Durrësit, Gjiri i Lalzit, Kavajës (Qerret, Spille), Semanit (Darëzezës), Divjakës, Vlorës (Zvërnec, Orikum), Palasës, Drimadhes, Dhërmiut, Jalës, Livadhes, Himarës, Qeparoit, Borshit, Lukovës, Sarandës, Ksamilit, Pogradecit dhe Linit.

Plazhi i Pogradecit është një plazh i cili ndodhet pranë qytetit të Pogradecit, në brigjet e Liqenit të Ohrit dhe si i tillë është plazhi më i madh liqenor në Shqipëri.

Lagunat të cilat kanë komunikim me detin janë habitate me kripshmëri të lartë dhe me hidrodinamikë të ulët. Habitati kryesor i lagunave bregdetare është sub – litoral.

Efektet direkte ose indirekte të nutrienëve në mjediset ujore dhe sasia e tyre ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ujërave larëse bregdetare dhe ujërave nëntokësore. Pjesa më e madhe e ndotësve kimik dhe mikrobiologjik e kanë origjinën nga aktivitetet njerëzore dhe shkarkimi i ujërave urbane të pa trajtuara që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e tyre.


Forcat shtytëse presioni, ndikimi, gjendja, reagimet për ujërat bregdetare




Cilësia e ujërave bregdetare në vendin tonë

Vlerësimi i cilësisë të ujërave të plazheve për parametrat mikrobiologjik Escherichia Coli (EC) dhe Intestinal Enterococce (IE), sipas kategorive që i përkasin numrit të stacioneve (shprehur në %, psh: 100% A-Cilësi e Shkëlqyer, nënkupton që ujërat në të gjitha stacionet janë të kategorise A)


Plazhi Velipojë




Plazhi Shëngjin




Plazhi Tale




Plazhi Gjiri i Lalzit



Plazhi i Kavajës




Plazhi Qerret







Plazhi Spille




Plazhi Seman-Darëzezë




Plazhi Divjakë




Plazhi Zvërnec



Plazhi Vlorë




Plazhi Orikum







Plazhi Palasë




Plazhet Dhërmi-Drimadhe




Plazhi Jalë




Plazhi Livadhe



Plazhi Himarë




Plazhi Qeparo







Plazhi Borsh




Plazhi Lukovë




Plazhi Sarandë



Plazhi Ksamil



Lin-Pogradec



Sipas rezultateve mikrobiologjike vlerësohen të cilësisë shumë të mirë plazhet e Zvërnecit, Palasës, Drimadhes, Jalës, Livadhes dhe Lukovës.

Faktori kryesor i ndotjes së ujërave bregdetarë të larjes mbeten shkarkimet e ujërave urbane të pa trajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte.

Cilësia e ujërave bregdetare në Dhërmi, Borsh, Lukovë, Zvërnec dhe Ksamil, Shengjin, Velipoje

Gjatë vitit 2022, vlerësohet përmirësim krahasuar me vitin 2021 i cilësisë të ujërave bregdetare të Dhërmiut, Himarës, Borshit, Lukovës. Ksamilit dhe Zvërnecit. Ndërkohë që vihet re përkeqësim i cilësisë të ujërave të Shëngjinit dhe Velipojës referuar vlerave të përmbajtjes së amonjakut.

Krahasuar me vitin 2020 kemi një tendencë të përmirësimit të gjendjes gjatë viteve 2021-2022.

Nga monitorimi në vitin 2023 vlerësojmë një cilësi të mirë të ujërave bregdetare për të gjithë parametrat fiziko – kimikë (oksigjeni i tretur, amonjak, nitrite dhe fosfori).

Ndikimi i shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave bregdetare

Në qytetin e Durrësit, ujërat urbane shkarkohen në det, në zonën e Porto Romanos (Spitalle), në qytetin e Vlorës shkarkohen në det në zonën e Pyllit të Sodës, kurse në qytetin e Sarandës shkarkohen në kanalën e Çukës e më pas në det.

Gjatë viteve 2022-2023, vlerësohet se stacioni në hidrovorin Vlorë-Pylli i Sodës klasifikohet me ndotje më të lartë duke vijuar me stacionin në Durrës në zonën e Porto-Romanos dhe Currilat.

Kjo tregon se ndikimi i shkarkimeve urbane në këto zona është më i lartë.

Cilësia e ujërave të Lagunës së Butrintit, Nartës dhe Karavastasë

Për vitin 2023 vlerësohet se kemi përkeqësim të gjendjes trofike në Lagunën e Butrintit duke kaluar nga cilësi mezotrofike në vitin 2022 në cilësi eutrofike.

	2020	2021	2022	2023
Laguna e Butrintit	Cilësi mezotrofike me tendencë eutrofie	Cilësi eutrofike	Cilësi mezotrofike	Cilësi eutrofike

Në lagunat e Butrintit, Nartës dhe Karavastasë, niveli i kadmiumit dhe plumbit është shumë i lartë. Kjo për shkak të ndikimit të ndotjes, hedhja e mbeturinave urbane, derdhja e ujërave të zeza të qytetit, veprimtaritë industriale dhe bujqësore, që e rritin sasinë e kadmiumit dhe plumbit.


Lagunat	2022	2023	
Butrint	Cilesi e keqe	Cilesi e keqe	Për shkak të përmbajtjes shumë të lartë të Cd dhe Pb. Parametrat Cu, As, Hg janë nën normë
Nartë	Cilesi e keqe	Cilesi e keqe	
Karavasta	Cilesi e keqe	Cilesi e keqe	



Veprimet që duhet të ndërmerren për ruajtjen e cilësisë së ujërave bregdetare

Cilësia e lumenjve kryesorë të Shqipërisë ka ndikim në cilësinë e ujërave nëntokësore, të deteve dhe në ekosistemet ujore. Për përmirësimin dhe ruajtjen e tyre kerkohet angazhimi i të gjithëve për të:

- Mënjanuar dhe minimizuar shkaktarët e ndotësve pasi impakti kryesor janë shkarkimet urbane dhe ato industriale të cilat derdhen direkt në liqene dhe në zona bregdetare .
- Respektuar standartet e përcaktuara nga Legjislacioni Shqiptar për shkarkimet e lëngëta nga subjektet prodhuese në ujërat pritës sipërfaqësorë.
- Kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e ligjit
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve për mos hedhjen e mbeturinave në plazhe
- Vënë në funksionim me eficiencë të plotë dhe zgjerimi i kapaciteteve të Impianteve të Trajtimit të Ujërave Urbane ekzistuese si dhe ngritja e Impianteve të rinj.
- Marrë masa (Pushteti Vendor) për plotësimin e kushteve higjieno sanitare të pushuesve në plazhet publike dhe në plazhet që administrohen nga privatët si dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave inerte si dhe mbeturinave urbane në plazhe.
- Zhvillimi i metodave parandaluese të cilat do të përfshijnë, kontrollin dhe/ose aplikimin e trajtimit të shkarkimeve të derdhura në lagunë.



Përgatiti dhe publikoi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Adresa: Rruga “Sami Frashëri” Nr. 4, Tiranë;

Web: www.akm.gov.al